

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me gjyqtarin Gëzim Pozhegu-kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve Shaqir Zika dhe Manudihe Sylja anëtar të trupit gjykues si dhe me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit N. G. nga fsh. N. e U., K. e Gj., për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktakuzën PP/I.nr.1881/2016 të datës 02.06.2017, në seancat e shqyrtimi gjyqësor publik të mbajtura me datat 28.12.2017, 05.01.2018, 10.01.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Agron Matjani, të akuzuarit N.G., mbrojtësit të tij Av. P.K. nga Gj.të dëmtuarit F. LL. si dhe përfaqësuesit të autorizuar të tij avokatit R.Gj. nga Gj. , me dt. 11.01.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. G.** , i biri i M.dhe nënës A., e gjinisë L., i lindur menë fshatin N. e U , Komuna e Gj. , ku dhe tani banon, i cili gjendet përkohësisht me punë të përkohshme në Gj. , me nr. personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se :

I.Me datën 17.08.2014 rreth orës 15:00-15:30/h, në fshatin N. e U. Komuna e Gj. , shkakton rrezik të përgjithshëm gjersa në ahengun e tij familjar, në shenjë gëzimi dhe festimi përdorë armën e tipit A.-7..., tip-1, kalibër 7.62 – 39 mm, me nr.serik 024905-85, ka shtënë disa herë në ajër, për çka nga një gjuajtje lëndohet rëndë në kokë nga pushka i dëmtuari F.Ll. gjersa gjendej së bashku me familjen e tij në oborrin e shtëpisë në fshatin L. duke punuar gjegjësisht paluar drunjë, në atë mënyrë pasi është dëgjuar një gjuajtje e pandërprerë me krismë-rrebesh plumbash, një predhë e armës i bie në kokë të dëmtuarit F. duke i shkakuar kështu lëndime të rënda trupore, të rrezikshme për jetën në momentin e shkakimit dhe pasoja të përhershme, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr .F. D. , dt.05.05.2017.

- **Me çka ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

II.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin e parë të aktakuzës, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën e zjarrit, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, në atë mënyrë që pasi është kontrolluar shtëpia e të pandehurit nga policia, i është gjetur një (1) pushkë automatike ASH-78 tip-1 (kopje e pushkës automatike AK-47), e kalibrit 7.62x39 mm, me numër serik 024905-85, e prodhuar në Shqipëri, e cila është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.

- **Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata me aplikimin e neneve 6, 7, 17, 41, 43, 45,46, 47, 69, par.2, neneve 73, 75, 76, nenit 365, par.8 lidhur me par. 1 të KPRK-së, nenit 374 par.1 dhe 3 të KPRK-së si dhe neneve 359, 360 par.2 dhe 365 par. 1 dhe 450, par.1 dhe 2 pika 2.6 nenit 463 par.2 të KPPK-së, të akuzuarin N. G. :

1.Për veprën penale nën pikën e parë të dispozitivit të aktakuzës, e

G J Y K O N

ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ NJË (1) VITI, i cili dënim duhet ta përmbushet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

2.Për veprën penale nën pikën e dytë të dispozitivit të aktakuzës, e

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ NJËMIJË EURO (1.500,00 €) .

Nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i njëjti dënim i shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej shtatëdhjetepesë (75) ditësh, duke llogaritur 20.00 €, për një (1) ditë burgim.

Ndaj të akuzuarin shqiptohet dënimi plotësues konform 374 par.3 lidhur me nenin 69 par. 1 të KPRK-së, bëhet konfiskimi i armës automatike e tipit ASH-78, tip-1, kalibër 7.62 x 39 mm, me nr.serik 024905-85, e cila ishte objekt i veprës penale.

Duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontest civil.

I akuzuari, obligohet që të paguajë gjykatës në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumën prej 50 €, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 50 €, të tëra këto në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktakuzë PP/I.nr.1881/2016 të datës 02.06.2017, ka akuzuar N.G. nga fsh. N. e U. K. e Gj. , për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 28.12.2017, i akuzuari deklarohet i pa fajshëm dhe nuk e pranon fajësinë për veprat penale i akuzuar në bazë të aktakuzës PP/I.nr.1881/16 të datës 02.06.2017.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar të mbajtur më dt. 28.12.2017, bëri ri cilësimin sa i përket veprës penale për të akuzuarin N.G. dhe atë nga vepra penale: lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.2 të KPRK-së, në veprën penale: shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Shqyrtimi dytë lidhur me këtë çështje penale është caktuar me datë 29.01.2018, mirëpo nuk është mbajtur meqenëse mbrojtësi i të akuzuarit N., av. N. D. me dt. 29.12.2017 me anë të parashtrës ka njoftuar Kryetarin e trupit gjykues se heq dorë nga shqyrtimi i dytë dhe ka kërkuar që meqenëse i mbrojturi i tij është i punësuar përkohësisht në botën e jashtme të caktohet shqyrtimi gjyqësor me arsyen se i mbrojturi i tij do të humbas punën.

Ku pas kësaj, Kryetari i trupit gjykues ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor në të cilën shqyrtim ka vendosur lidhur me kërkesën penalo-juridike të prokurorit të shtetit me përmbajtje si në aktakuzën e parashtruar.

Në fjalën hyrëse Prokurori i shtetit ka deklaruar : Aktakuzën nën PP/nr.1881/2016 të dt. 02.06.2017, të ngritur nga ana e PTH DKR në Gjakovë, kundër këtu të akuzuarit N.G. nga N. e UL., Komuna e Gj. , i akuzuar për vepër penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e kemi mbështetur në këto prova: dhe ate në raportin e ekspertimit nga Agjensia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, dt. 04.11.2016, raportin informues dhe listën e dëshmive me numër 20147-DB-1429 të dt. 17.08.2014, raporti mbi këqyrjen

e vendit të ngjarjes me numër dhe datë të njëjtë, raporti mjekësor i QKUK-së në Prishtinë datë 25.09.2014, fletë lëshimi me epikrizë ne 278 /2014 dt. 19.09.2014., fletë lëshimi nga QKUK nr.7193 datë 08.10.2014, kosntatimi skenografik i datës 19.12.2014, konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko ligjor dr.V. H. i datës 05.01.2017, konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko ligjor dr. F. D. , datës 05.05.2017, dëshmia e të dëmtuarit F. Ll. , dëshmia e dëshmitarëve D.dhe M. LL. , ashtu që kemi gjetur se këto prova janë më së të mjaftueshme të cilat mbështesin përtej dyshimin e bazuar përkatësisht mbështesin tezën e akuzës dhe se i akuzuari N. G. ka kryer veprat penale si në aktakuzë.

Në fjalën hyrëse i dëmtuari F. Ll. ka deklaruar se : Pajtohem në tërësi me fjalën hyrëse të prokurorit, i njëjti ka deklaruar se kërkon kompensim të dëmit material, për shumën do të deklarohem në fjalën përfundimtare si dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit N. G. , av. P. K. , ka deklaruar : Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pas administrimit të provave dhe gjendjes faktike nuk do të vërtetohet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, e datës 02.06.2017, se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Gjithashtu gjatë këtij shqyrtimi d do të vërtetohet se gjendja faktike në raportin e ekspertimit nga Agjensia Kosovare për Forenzike e dt. 04.11.2016 si dhe deklaratat e të dëmtuarit, dëshmitarëve si dhe deklaratat e të akuzuarit nuk do të vërtetohet aktakuza për të cilën ngarkohet i mbrojturi im.

Në fjalën hyrëse i akuzuari N. G. ka deklaruar se : e mbështesë në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit tim.

Prokurori i shtetit Agron Matjani në fjalën përfundimtare ka deklaruar :

I nderuari Kryetar, anëtarë të trupit gjykues, të nderuar të pranishëm, në seancat e mbajtura në këtë gjykatë dhe nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari N. G. nga fshati N. e U., Komuna e Gj. ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale të armëmbajtjes pa leje nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarit F. Ll. dëshmitarëve D. Ll.-bashkëshortes, djalit M. Ll. nga ekzspertiza e AKF-së lidhur me ekzaminimin e armës dhe predhës si dhe gëzhgjës, nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, nga raportet mjekësore të lëshuara nga SR “Isa Grezda” në Gjakovë, raportet e QKUK-së në Prishtinë, nga mendimi i ekspertit mjeko ligjor Dr. V. H. dhe Dr. F. D.si dhe nga provat tjera të cilat janë bashkëngjitur aktakuzës, po ashtu edhe nga mbrojtja e të akuzuarit N. G.

Sa i përket gjendjes faktike është vërtetuar se me datën 17.08.2014, rreth orës 15:15 minuta, në fshatin N. e U., Komunës së Gj., i akuzuari N. G. duke përdorur armën e zjarrit dhe ate armën automatike të tipit ASH 78 kal.7.62 x 39 mm me nr.serik 024905-85, ditën kritike ka shtënë 3-4 herë me të njëjtën armë në ajër, pasi që atë ditë ka pasur një aheng familjar dhe kanë festuar pagëzimin e djalit, me ç’ rast nga një fishekë ose predhë në shtëpinë e tij në fshatin L. B. K. e Gj. , me një predhë është goditur në pjesën e epërme të kokës së djathë, i dëmtuari F. Ll., me ç’ rast ka marrë lëndime të rënda trupore që në atë moment kanë qenë të rrezikshme për jetën e tij, i njëjti nga plaga e marrë ka mbetur i paaftë për çfarë do pune, pasi që nuk i punon dora dhe këmba e majtë të njëjtit.

Nuk është kontestuese fakti se ditën kritike i akuzuari ka gjuajtur me këtë armë automatike, ku edhe vet i akuzuari N. ka pranuar se ka gjuajtur, çka edhe ora përputhet kur është shkaktuar plaga në kokën e të dëmtuarit me këtë predhë, i njëjti ka deklaruar se ka gjuajtur me armë kur ka dhënë deklaratën në polici, përkundër asaj se sot deklaraten e tij ka e ka ndërruar dhe ka deklaruar se ka gjuajtur në orën 12.30 minuta.

Edhe vet i akuzuari ka deklaruar se arma pasi që ka gjuajtur e ka fshehur një herë në pazllom-garazhë, mirëpo më vonë pas një ore – një orë e gjysmë, të njëjtën armë të mbuluar me najlon e ka fshehur në afërsi të varrezave. Pasi që ka ardhur policia i njëjti vullnetarisht e ka dorëzuar armën. Dhe se policia në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit, në vendin e ngjarjes ka gjetur një gëzhojë. Pas operacionit që ka pasur këtu i dëmtuari F. LL. , nga koka e tij është nxjerrë edhe predha me të cilën është plagosur i dëmtuari së bashku me gëzhojë dhe pushkën automatike janë dorëzuar në ekzaminim balistik në AKF në Prishtinë, ku nga ana e ekspertëve të balistikes Sh. Sh. dhe I. K. është konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me një pushkë automatike ASH 78 tipi 1, kopje e pushkës automatike AK 47 kal.7.62x39 mm, me nr.serik : 024905-85, kjo armë ka qenë funksionale, karikatorin ka qenë i zbrazët, e cila ka kapacitet prej 30 fishekëve të kalibrit të njëjtë, ndërsa gëzhjoja e cila është gjetur në vendin e ngjarjes është pjesë e fishekëve të kal.7.62x39 mm, dhe se kjo gëzhjojë është shkrepur nga pushka automatike ASH 78 tipi 1, kopje e pushkës automatike AK 47 kal.7.62x39 mm, me nr.serik : 024905-85, dhe se predha e cila është nxjerrë nga koka e të dëmtuarit është pjesë e fishekëve të kalibrit 7.62 x 39 mm, dhe se kjo predhë është shkrepur nga pushka automatike e lartcekur.

Edhe nga ekspertiza mjeko ligjore e dr. Fl. D. të dt. 05.05.2017, konstatohet se i dëmtuari F. Ll. ka pësuar lëndime trupore që paraqesin plagë të shkaktuara nga arma e zjarrit, në regjionin tëmthor të anës së djathtë të kokës dhe si të tilla këto lëndime bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetën e të dëmtuarit në momentin e shkaktimit dhe me pasoja të përhershme si dhe paaftësi për punë.

Andaj, edhe pse i akuzuari N. G. nuk e pranojë fajësinë për veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm të gjitha provat dëshmojnë se i njëjti ditën kritike ka gjuajtur me pushën automatike duke plagosur në kokë të dëmtuarin F. Ll. dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme për çfarëdo pune.

Propozojë trupit gjykues që të akuzuarin N. G. ta shpalli fajtor për dy vepra penale që akuzohet dhe të njëjtit ti shqiptohet një dënim sipas ligjit, duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat qëndrojnë në anën e tij, sidomos faktin se këtu i akuzuari N. G. , nuk ka pasur dashje, por këtu ka pasur pakujdesi, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata duhet të ketë parasysh faktin se këtu i dëmtuari F. Ll. ka mbetur i paaftë për punë dhe ka mbetur invalid i përhershëm.

Po ashtu propozojë që gjykata të konfiskojë pushën automatike, karikatorin, predhën dhe gëzhjojen të cilat janë objekt i kryerjes së veprës penale në kuptim të nenit 374 par.3 të KPRK-së, e po ashtu propozojë që gjykata të obligojë të akuzuarin që ta obligojë që të paguajë paushallin dhe shpenzimet e procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. R. Gj. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar :

Të nderuar kryetar dhe anëtar të trupit gjykues dhe pjesëmarrës tjerë në seancë unë deklaroj se e mbështesë fjalën përfundimtare në tërësi të prokurorit dhe nuk do ti përsërisë fjalët e tij. Pala e dëmtuar i bashkëngjitet ndjekjes penale, por e njëjta nuk e ka qëllimin e dënimit sa ka problem kompensimin e gjendjes së shkaktuar me rastin e përdorimit të armës së zjarrit, andaj theksojë se kërkojmë kompensim të dëmit material dhe jo material, sepse me rastin e lëndimit i njëjti ka pësuar dhimtë të intensitetit të lart, të mesëm dhe dhimtë vazhdojnë edhe më tutje, pastaj frika është prezentë, shëmtimi, dhe më kryesorja invaliditeti i përhershëm, paaftësia për të punuar, zvogëlimi i aktivitetit jetësor. Nga kjo ngjarje ka pasur idhnmim edhe vet i akuzuari pasi që ka pasur ahengun e djalit të mitur, mirëpo i dëmtuari është dëmtuar për jetë dhe i propozojë gjykatës që ta gjykojë dëmin sipas bindjes së vet të lirë duke marrë parasysh dokumentacionin mjekësor i cili është administruar si provë gjatë këtij gjykimi ose shumën në emër të kompensimit të dëmit material ta udhëzojë në kontest civil.

I dëmtuari F. Ll. në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar: se pajtohet me fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të autorizuar av. R. Gj. dhe nuk ka çka të shtojë më tepër.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. G. av. P. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar:

I nderuari, z.Kryetar dhe anëtarë të trupit gjykues, prokuror i shtetit, koleg avokat dhe pjesëmarrës të pranishëm, ne si mbrojtje gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, lidhur me vërtetimin e faktit nga aktakuza janë administruar shumë prova të natyrës personale dhe materiale në fund e ka dhënë mbrojtjen edhe i akuzuari N. G. , ne mendojmë se kësaj mbrojtje të tij duhet falur besimin se nuk është kryes i veprës për të cilën pretendon prokuroria , po ashtu gjatë administrimit të provave ne si mbrojtje kemi identifikuar disa fakte që janë kontestuese apo të kundërshtueshme.

Sipas aktakuzës, së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I.nr.1881/16 i mbrojturi im është akuzuar për veprë penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.3 lidhur me par. 2 pika 2.5. ku në shqyrtimin fillestar është bërë rikualifikimi i veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur me par.1 si dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Pas administrimit të provave, mbrojtja mendon se vepra penale nga dispozitivi i parë i aktakuzës përkatësisht për veprë penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur me par. 1 të KPRK-së, nuk është vërtetuar , për faktin se fillimisht aktakuza sa i përket kësaj vepre është ngritur vetëm duke u bazuar në ekspertizën e Agjencisë Kosovare për Forenzikë të datës 04.11.2016 kinse predha e cila është gjetur në kokën e të dëmtuarit F. Ll. është predha e cila është shkrepur nga pushka automatik AK 47 e kalibrit 7.62x 39 me numër serik 02490585 e prodhuar në Shqipëri të cilën e ka poseduar ditën kritike i akuzuari N.. G. .

Ndërsa sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuari e ka pranuar këtë veprë se arma ka qenë e tij, por i njëjti nuk është kryes i veprës penale të akuzuar nga dispozitivi i parë i aktakuzës.

Eksperti I. K. në shqyrtimin gjyqësor gjatë elaborimit të ekspertizës nuk ka qenë i qartë dhe bindshëm në pyetjet e mbrojtjes se çfarë kohe nevojitet për përshkrimin e pikës zero në ajër predha e gjer te kthimi në tokë duke u arsyetuar se nuk i kemi bërë përlllogaritjet e duhura për armën në fjalë dhe se për këtë gjë duhen metoda të justifikuara që ne nuk i kemi, gjithashtu në pyetjen e mbrojtjes

eksperti ka deklaruar se koha e cila kalon pa u bërë ekspertiza mund të vijë deri te konsumimi i vjaskave të armës dhe predhës, për çka do mund të vështirësonte ekzaminimin e qind për qind të armës.

Eksperti ka jap shpjegim se gjuajtja në këndin nëntëdhjetë shkallë mundësia e predhës që më së largu nga caku i gjuajtjes është gjer në dyqind metra, me çka ky fakt vërtetohet edhe nga mbrojtja e dhënë e të akuzuarit i cili ka gjuajtur në drejtim 90 shkallë pasi që për rreth ka zidin e shtëpisë dhe garazhin dhe ky fakt e përjashton mundësinë që i akuzuari të mund të ketë gjuajtur në kënd 45 shkallë që do të arrinte largësinë 2-3 kilometra dhe si pasojë e kësaj gjuajtje të ketë goditur të dëmtuarin.

Në deklaratën e dhënë në prokurori dhe në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor i akuzuari N. G. ka deklaruar se me datën 17.08.2014 ka pasur zifafet ku e ka pagëzuar djaln e tij në kishë dhe pas kthimit nga pagëzimi ka filluar ahengu në shtëpinë e tij ku kishte pasur të ftuar 50-60 mysafirë dhe pasi ka filluar ahengu i akuzuari kishte gjuajtur me pushkë automatike AK 47 në oborrrin e tij 3-4 herë dhe gjuajtjen e kishte bërë dikund rreth orës 12-13.30 minuta dhe më pas e kishte lënë armën në garazhin e tij afër një ore- një orë e gjysmë, në pyetjen e mbrojtjes deklaroi se gjatë asaj kohe ka pasur të shtëna armësh jashtë oborrrit tim në rrugë por të cilët unë nuk i kam parë pasi që isha i angazhuar me mysafir, në pyetjen e mbrojtjes i akuzuari deklaroi se: armën e ka lënë me fishek të mbushur dhe pasi e kishte qar në lluga, të varret, nuk e ka kontrolluar se : a ka pasur plumba por një gjë të tillë e ka vërtetuar pasi kanë ardhur policia, e kanë parë se nuk ka plumba, dhe për ne si mbrojtje ngritët dyshimi se gjatë asaj kohe sa ka qëndruar arma në garazhe dikush tjetër të ketë përdorur, ku i akuzuari nuk e ka vërejtur nga se ka qenë me mysafir dhe po ashtu me ndikim të alkoolit në sasi të konsumuar 1.28 promila, testi i bërë nga policia.

Nga deponimi i dëshmitarëve si : M. Ll. , D. Ll. si dhe dëshmisë së të dëmtuarit F. Ll. nuk është vërtetuar fakti se ditën kritike në kohën dhe vendin e cekur si në aktakuzë se i akuzuari N. G. ni ka gjuajtur me armë.

Nuk është kundërshtuese fakti se i mbrojturi im ditën kritike pikërisht me datën 17.08.2014 rreth orës 12-13-13.30 min., ka dalur në oborrrin e tij dhe ka gjuajtur me armë, këtë fakt i njëjti e ka pohuar edhe në shqyrtim kryesor në mbrojtjen e tij i cili ka deklaruar se ka gjuajtur rreth orës 12-30/h dhe se vetëm ky ka gjuajtur brenda oborrrit të tij ndërsa personat tjerë mysafirët kanë gjuajtur në rrugë.

Nga raportet provat e siguruar nga policia dhe prokurori nuk është siguruar ndonjë raport ku është bërë marrja e gjurmëve të barutit me të cilën është gjuajtur me armë se ato gjurmë të barutit a gjinden në duart e të akuzuarit apo në trupin e tij për të vërtetuar se a ka lidhje, se a përputhen gjurmët e barutit të pandehurit me armën të cilën e ka përdorur, dhe se a është personi i cili ka gjuajtur me armë.

Prokuroria thirret në fakte duke u bazuar në ekspertizën e AKF dt. 04.11.2016 pasi për ne si mbrojtje ka qenë e pa qartë dhe kemi bërë vërejtjet tona rreth ekspertizës ku kemi propozuar një ekspertizë të re dhe nga ana e gjykatës ky propozim na është refuzuar për çka ne si mbrojtje mendojmë se do ti kishte kontribuar në të mirën e zbardhjes së kësaj çështje dhe heqjes së dilemave sa i përket armës së përdorur, pastaj paqartësitë tjera janë se vepra nëse është kryer nga këtu i akuzuari apo ndonjë person tjetër, sepse gjitha provat personale materiale, dëshmitë e dëshmitarëve

nuk e vërtetojnë këtë rrethanë se i akuzuari N. G. paraprakisht ka kryer këtë veprë për të cilën ngarkohet.

Mbi këto baza, konsiderojë se nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar. Andaj mbi bazën e kësaj, gjykatës i propozojë që të merr aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit N. G. nga se nuk është provuar se ka kryer veprë penale për të cilën akuzohet, e gjithë këtë mbi bazën e provave të administruara.

I akuzuari N. G. ka deklaruar : se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çka të shtoj.

I.GJENDJA E FAKTEVE

Në këtë çështje penale gjykata ka vërtetuar se : Me datën 17.08.2014 rreth orës 15:00-15:30/h, në fshatin N. e U.Komuna e Gj., N. G. shkakton rrezik të përgjithshëm gjersa në ahengun e tij familjar, në shenjë gëzimi dhe festimi përdorë armën e tipit ASH-78, tip-1, kalibër 7.62 – 39 mm, me nr.serik 024905-85, ka shtënë disa herë në ajër, për çka nga një gjuajtje lëndohet rëndë në kokë nga pushka i dëmtuari F. Ll. j gjersa gjendej së bashku me familjen e tij në oborrin e shtëpisë në fshatin L. duke punuar gjegjësisht paluar drunjë, në atë mënyrë pasi është dëgjuar një gjuajtje e pandërprerë me krisma-rrebesh plumbash, një predhë e armës i bie në kokë të dëmtuarit F. duke i shkakuar kështu lëndime të rënda trupore, të rrezikshme për jetën në momentin e shkakimit dhe pasoja të përhershme, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr.Fl. D., dt.05.05.2017, me çka ka kryer veprën penale shkakim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Dhe me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin e parë të aktakuzës, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën e zjarrit, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, në atë mënyrë që pasi është kontrolluar shtëpia e të pandehurit nga policia, i është gjetur një (1) pushkë automatike ASH-78 tip-1 (kopje e pushkës automatike AK-47), e kalibrit 7.62x39 mm, me numër serik 024905-85, e prodhuar në Shqipëri, e cila është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Këtë gjendje të fakteve gjykata e ka vërtetuar në bazë të dëshmimeve të dëshmitarit - dëmtuarit F. Ll.j, dëshmitarit M. Ll. dhe dëshmitares D. LL. , dhe provave nga raporti i ekspertimit nga Agjensia e Kosovës për Forenzikë, ekspertit të balistikës I. K. AKF/2016-1465/2016-1216 datës 04.11.2016, listës së dëshmimeve i datës 17.08.2014, raportit informues me numër 2014-DB-1429 datës 17.08.2014; raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes datës 17.08.2014; raporti mjekësor i QKUK-së në Prishtinë i datës 25.09.2014, fletë lëshimi me epikrizë me numër 278/2014 datës 19.09.2014; fletë lëshimi nga QKUK-ja nr.7193 datës 08.10.2017; nga konstatimi skenografik dt.19.12.2014, nga raportet shitesë për të dëmtuarin F. Ll; nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko ligjor dr. V. H. i datës 05.01.2017; konstatimi dhe mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr.F. D. , me nr. Ref. 02/2017 datë 05.05.2017.

I dëmtuari F. Ll. në shqyrtimin gjyqësor dhe procedurën hetimore ka deklaruar:

Me këtu të akuzuarin N. G. , para ngjarjes kritike nuk kam pasur ndonjë mosmarrëveshje, e kom njohur por më shumë ia kam njohur familjarët.

Ditën kritike kam qen në oborr timin, me krejt familjarët duke paluar dru, ora ka qenë 15:30 minuta. Kam dëgjuar rrebesh të shtënash dhe kam ra përtokë , pastaj familjarët më kanë marrë dhe më kanë quar në spital në Gjakovë.

Ai rrebesh shtënash, jam goditur në pjesën e sipërme të kokës dhe plumbi më ka mbetur brenda dhe gjatë operacionit të njëjtin e kanë nxjerrë në anën e djathtë të kokës pas veshit . Jo nuk mujt me pa plumbin duke ardhur, kam qenë nën shelgje duke renditur drurët.

Krismat kanë ardhur nga drejtimi i fshatit N. e U. . Në momentin kur jam rrëzuar në tokë .

Shumë pak kom pasur vetëdije, mu është dukur se jam në ëndërr.

40 ditë kam qëndruar në spital në QKUK-në në Prishtinë, aty gjatë qëndrimit në spital kam pasur 1 operim dhe shlyqyr Zotit kam pasur sukses. Para se me dëgjuar breshërinë e armëve, nuk kam dëgjuar përpara të shtëna

Prej policisë kam kuptuar se nga kush jam plagosur , po ashtu ka qenë edhe një person kur kam ardhur prej spitalit, ka ardhur me më vizituar dhe më ka treguar. Nuk e ki se kush u kon.

Në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur rasti, me mu prezentë kanë qenë bashkëshortja D., djali M., dhe 2 vajzat M. dhe M., dhe reja e djalit B. .

Pasi e kam kuptuar se kush më ka shkaktuar lëndimin, nuk kanë pasur kontakt familja ime me familjen e të akuzuari, nuk ka qenë dikush nga familja e të akuzuarit tek unë. Jam i bindur se këto lëndime mi ka shkaktuar këtu i akuzuari N.. Pasi që e kam marrë veten, asnjëherë nuk e kam takuar.

Në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit N. G.av. P. K. nga Gj., dëshmitari përgjigjet

Vërteta është se rasti ka ndodhur në mes të orës 15:00 – 15:30/h, unë kam dëgjuar vetëm një rrebesh, dhe më ka ndodhur rasti, më tepër nuk di.

Intervali kohor nga rrebeshi deri tek goditja juaj, ndoshta nga rrebeshi deri tek plagosja ka zgjatur për afërsisht 15-20 sekonda, sa më kujtohet mua.

Nuk ke di, sa është largësia vijë ajrore nga N., shtëpia e të akuzuarit, deri në L. B. shtëpia e ime.

Av.P. K. : Në pyetjen e prokurorit thatë se ju ka treguar edhe një person që ka qenë polic nga I. dhe , ju ka treguar se kush ka gjuajtur, nuk iu ka treguar emrin, dhe ai person është nga N... A të ka treguar konkretisht se cili person apo familje ka gjuajtur?

Dëshmitari përgjigjet, Jo nuk më ka treguar cili person as cila familje.

Gjatë kësaj kohe para se me më ndodhur rasti apo para, nuk kam pasur konflikt me ndonjë familje apo person.

Pas ngjarjes, jam njoftuar nga miqtë e mi që janë nga N., se ka pasur aheng në familjen G..

Deri në muajin maj kur jam marrë në pyetje në prokurori, nuk kam ditur asgjë, se kush ka gjuajtur me armë dhe Unë jam qëlluar. Kur më ka qëlluar plumbi, kam qenë në këmbë.

Tani pas operacionit nuk jam në gjendje për të punuar, as për nevojat e mija personale në tërësi, jam në përcjelljen e shoqes.

Tani muj me e lëviz dorën e majtë shumë pak, kurse këmbën e majtë pak më shumë, por jo si të djathtën.

Para se me ndodhur rasti, kam punuar në firmën Art konstreshën, kam punuar punëtor fizik me mëditje, ku kam pasur pagën 20 € në ditë, të dielën nuk kam punuar.

Tani përdori ilaçe për tension, dhe bëjë fizioterapi në spital në Gjakovë, dhe kontrollin mjekësore e bëjë 1 herë në muaj në QKUK- në Prishtinë.

Kompensim dëmi kërkojë.

Prokurori i shtetit Agron Matjani propozon mbrojtësit të akuzuarit av. P. dhe të akuzuarit nëse kanë vullnetin që të arrihet marrëveshje mbi pranimin e fajësisë lidhur me këtë çështje penale. Nëse ka nevojë propozojë që të ndërpritet shqyrtimi gjyqësor përderisa të konsultohet i akuzuari me mbrojtësin e tij lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N., av. P. K. sipas sugjerimeve dhe konsultimeve me të mbrojturin e tij, nuk janë të pajtimit që të negociojnë lidhur me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Dëshmitarja D. LL.

Në pyetjen e Prokurorit të shtetit dëshmitarja deklaron:

Mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori, me datë 08.05.2017.

Prokurori: Ditën kritike kur ka ndodhur rasti, a mundesh me na tregu si është?

Dëshmitarja: Atë ditë kur është plagosur bashkëshorti im F. Ll. ka qenë ditë e diele, 17.08.2014, jemi dal rreth orës 15:15 – 15:30/h nuk jam e sigurt saktë kemi dal në oborr të shtëpisë për me i paluar drunjët, nuk e di pas 15 minutave që kemi dal në oborr kemi dëgjuar krisma të mëdha, bile në atë moment, ka thënë burri im : “ iu thaftë dora se kush është duke qitur”, unë i thashë : Mos nem, më pas 15 sekondave a 20 sekondave nuk e di bashkëshorti ka ra në tokë dhe e ka kapluar gjaku. Kom piskatë : iu shka u bo, djali e ka kuptuar se ishte plumb qorr, djali i ime quhet M. , 7-8 anëtar të familjes kemi qenë atë ditë me një vend. Në atë moment menjëherë djali ka marrë automjetin dhe e kemi dërguar në spital në Gj. , unë kam qenë me djalin, burrin dhe me kunatin, ku së bashku e kemi dërguar në Emergjencë në Gjakovë, djali e ka thirrur policinë dhe e ka njoftuar, pastaj prej Gjakovës burrin e kanë dërguar në QKUK-së në Prishtinë, ku e kanë operuar mjekët, të cilët nuk na kanë lënë me e dërguar jashtë shtetit, ku na kanë thënë se jeta e tij është në rrezik dhe nuk mund të përballojë. Gjatë operacionit ia kanë hekur plumbin nga koka.

Atë ditë afër nesh nuk ka pasur dasmë.

Kam ditur por te N. nuk ka pasur dasmë, ka pasur zifafet për djalë, këtë e di se njihemi dhe se burri i ka miq kurse unë i kam nun familjen e N. dhe për këtë arsye njihemi mirë.

Prej ditës që është plagosur burri im nuk ka qenë në gjendje me punua, e as vetëm me shkua për nevoja personale.

Po e njoh N. G. , meqenëse jemi nun-kumar, por pasi që jam martuar me ju treguar të drejtën tash jam te burri, dhe i kam harruar dajtë, nunët, etj., por familjen e tij më ka ra mi pa nëpër vdekje, dasma.

Nuk ka qenë askush nga familja e N. apo N. me na vizituar pas ngjarjes.

Në pyetjen e mbrojtësi Av. P. K. të parashtruara dëshmitares. Dëshmitarja përgjigjet S' kemi ndi krisma deri sa kemi qenë në shtëpi brenda. Ka qenë vetëm një rrebesh pandërprerë.

Kur kam dëgjuar rrebeshin, F. ka qenë i ulur përfundi shelgjes duke paluar dru, dhe kur është rrezuar, aty ka qëlluar.

Neve nuk na ka thënë se kush ka gjuajtur vetëm atë se çka ka konstatuar policia.

Pozita e bashkëshortit tim kur është qëlluar ka qenë në këmbë, është përkulur .

Vija ajrore nga fshati N. deri në Fshatin L. B. sipas mendimit tim duhet me qenë 1 kilometër deri në 2 kilometra.

Dëshmitari M. Ll. :

Në pyetjen e prokurorit dëshmitari përgjigjet:

Është e vërtet se kam dhënë deklaratë në prokurori me dt. 08.05.2017, dhe mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori me dt. 08.05.2017.

Baba është plagosur me dt. 17.08.2014, ka qenë ditë e diele, mbas shtëpie duke paluar dru, edhe gjatë asaj kohe kemi qenë të lumtur, pasi që ato ditë e kom pas martesën time dhe kemi qenë së bashku si familje, dhe në ato momente kemi dal në oborr dhe ashtu siç ishim së bashku kemi filluar me palu drutë. Dhe në ato momente kemi dëgjuar një breshëri, unë mendoj se ka qenë një zbrazje e plotë e karikatorit edhe pse nuk jam ekspert për këtë çështje po ashtu e ka perceptuar, ka ardhur zbrazja dhe pas disa sekondave, pas zbrazjes së armës që kam dëgjuar e kom vërejtur se baba para syve të mi është rrëzuar para këmbëve, në ato momente iu kom afruar afër, dhe menjëherë kam kuptuar se bëhej fjalë për plumb qorr. Kom dit se është plumb qorr, ku mundet me u pa gjithçka, kom kontrolluar hapësirën dhe nuk kam vërejtur asgjë të dyshimtë edhe pse ne nuk kemi pasur hasmëri me dikend, por thjeshtë kam kontrolluar përreth vendit të ngjarjes.

Baba ka qenë në këmbë, mbrapa shtëpisë duke paluar drutë, dhe në momentin kur është qëlluar ka qenë duke ecur, dhe ka qenë larg nga vendi ku kemi paluar drutë 2-3 metra.

Nuk ka pasur dasmë askush afër nesh atë ditë. Nuk e di, se në Novosellë ka pasur dikush dasmë.

Më kanë treguar policia, që ka pasur darsëm apo ahengje në Novosellë.

Si person këtu të akuzuarin N. G. nuk kam ndejtur personalisht me te, por e njoh meqenëse kemi një lloj miqësie me te, e njoh si figurë.

Nuk ka ardhur N. në shtëpinë ton, apo ka dërguar dikën në shtëpinë ton pas ndodhjes së rastit, absolut jo.

Na nuk i kemi qua ndonjë selam familjes së N., për rastin që ka ndodhur, vetëm nëse ka qarë dikush tjetër që ne nuk e dijm.

Pas ditës kur është plagosur baba në momentin që po e shihni është mbretë, në krahasim qysh është kon, ka qenë shumë keq, së pari në fillim ka qenë tri javë në gjendje kome, pastaj një kohë deri sa ishte në Prishtinë në shërim nuk ka pasur orientim se ku ishte, pasi është kthyer në shtëpi herë- herë e ka pasur situatën e mjegulluar, por kohë pas kohe është përmirësuar gjendja e tij, në gjendjen siç po e shihni. Për babën tani për tani kujdeset nëna, por pas muajve të parë pas plagosjes është dashtë që të kujdesen 2-3 persona.

Mbrojtësi Av. P. K. i parashtron pyetje dëshmitarit. Ku dëshmitari përgjigjet:

Prej dëgjimit të rrebeshit deri sa është goditur baba, janë shkuar dikund 15-20 sekonda.

Më herët nuk kam dëgjuar të shtëna, vetëm kam dëgjuar një rrebesh, pas lëndimit të babës nuk kam dëgju, jom marrë vetëm me babën.

Vija ajrore prej N. së U. deri në L. B. deri tek ne është 2km deri në 3 km. besoj, por nuk jam i sigurt, por këtë perceptim po e japi prej mendjes sime, ndoshta nuk është.

Predhën që është goditur baba, e kom pa, e kam në telefon, po me e prek nuk e kom prek. Nuk muj me thënë se çfarë predhe ka qenë, çfarë lloji i armës pasi që nuk jam adhurues i armëve.

Nuk kanë thënë se e ka gjuajtur N., por kanë thënë se është gjuajtur në familjen G. .

Policia më ka njoftuar se kanë dalur në çdo vend ku ka pasur ahengje dhe nuk kanë specifikuar se ku ka qenë ahengjet, por kanë thënë se kanë dal në të gjitha ato vende ku ka pasur të shtëna.

Mbrojtësi i të akuzuarit N., Avokati P. K. propozon që në cilësinë e dëshmitarit të ftohen edhe F. G.i, M. G., L. G. që të tre nga fshati N. e U.t, si dhe V. B. të cilët deklarata e tyre do të shërbejë si provë për të treguar gjendjen faktike, reale, se kur ka përfunduar ahengu, kur janë shtënë të gjuajturat, si dhe arma nga e cila është shtënë.

Prokurori i shtetit Agron Matjani lidhur me propozimin e mbrojtësit av.P. K. deklaron se lidhur me dëshmitarët që propozon mbrojtësi është i panevojshëm, duke marrë parasysh faktin se i akuzuari N.

G. , ka pranuar se ditën kritike ka gjuajtur nga arma automatike tip ASH 78 me nr. serik 024905-85 të kal. 7.62 x 39 mm, dhe nga ekspertiza e AKF lidhur me ekzaminimin balistik të armës dhe gëzhgjës, predhës që është gjetur në kokën e të dëmtuarit F. Ll. është konstatuar se predha është gjuajtur nga kjo armë, si dhe gëzhgoja e gjetur në vendin e ngjarjes përputhet plotësisht me fishekun, andaj propozimi i mbrojtësit është i panevojshëm dhe propozojë trupit gjykues që këtë propozim ta refuzojë.

Trupi gjykues lidhur me propozimin e mbrojtësit të akuzuarit N. G. , av. P. K. , ka marrë aktvendim me të cilin ka refuzuar propozimin e mbrojtësit për marrjen në pyetje të dëshmitarëve F. G. M. G., L. G. që të tre nga fshati N. e U., si dhe V. B. , nga se në ekspertizën AKF për ekzaminimin balistik të armës, është konstatuar se plumbi i nxjerrë nga koka e të dëmtuarit F. , përputhet me armën e cila iu është gjetur të akuzuarit, më gjerësisht si në ekspertizë.

Nga dëshmitë e dëshmitarëve Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka qenë në fshatin N.e u., K. Gj. , dhe se ditën kritike nuk ka qenë në fshatin L.r K. Gj. , se ditën kritike në shtëpinë e të akuzuarit është organizuar një aheng familjar me rastin e lindjes së djalit, është gjuajtur me armë zjarri në pa destinim të caktuar dhe më këtë rast një predhë ka goditur të dëmtuarin F. Ll. në oborrin e shtëpisë së vet në fsh. L. K. Gj. Të dëmtuarin e kanë dërgua në Qendrën Spitalore ‘ ‘ Isa Grezda ‘ ‘ në Gjakovë, për ti dhënë ndihmën e mjekësore .

Nga fletë lëshimi me Epikrizë nr. të dt. 19.09.2014, lëshuar nga Qendra klinike Universitare e Kosovës, është konstatuar se ndaj të dëmtuarit ka pas intervenim kirurgjik për shkak të goditjes në kokë në anën e djathtë me një plumb.

Nga raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ekspertit të balistikës I. K. datës 04.11.2016 , dhe dëshmisë së dhënë në shqyrtimin gjyqësor më dt.10.01.2018, gjykata ka vërtetuar se :

Në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit N. G. , Eksperti i balistikës I. K. përgjigjet:

Po e kemi përpiluar ekspertizën e datës 04.11.2016 së bashku me ekspertin e lartë Sh. Sh. dhe mbetem pranë saj.

Në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë ne kemi pranuar provat një pushkë automatike ASH 78 prodhim i Shqipërisë , e cila është variant i pushkës automatike AK 47 e kalibrit 7.62 x 39 mm, me numër serik 024905-85, një karikator po të njëjtës armë, një gëzhgjë e cila është pjesë e fishekut të kalibrit 7.62 x 39 mm dhe një predhë e cila është pjesë e fishekut të kalibrit 7.62 x 39 mm, këto janë provat që ne i kemi ekspertuar dhe që janë kërkuar me vendim të prokurorit të shtetit me nr. PPN/L.nr.148/2014.

Vjaskat apo lugjet dhe brigjet janë ullaqe të gdhendura në brendësinë e tytës së armëve të vjaskuara dhe që shërbejnë për të dhënë moment rrotullues predhës, që ajo pas shkrepjes të fluturojë në distancë më të lartë, të ruaj trajektorejen e lëvizjes dhe të ketë precizitet.

Vjaskat, lugjet apo brigjet varet prej llojit të armës dhe dizajnit, në aspektin mikroskopik janë të ndryshme tek secila armë. Karakteristikat mikroskopike të vjaskave janë karakteristike për secilën armë dhe nuk ekziston mundësia që një predhë e shkrepur nga një armë të përputhet me një predhë të shkrepur nga një armë tjetër. Karakteristikat individuale të pjesëve të armëve janë unike vetëm për atë armë ose janë unike sikurse gjurmët e gishtërinjve që janë tek secili person.

Unë sapo dhashë përgjigjen që secila pjesë e armëve shkakton gjurmë të cilët janë unike vetëm për atë armë, kur them gjurmë unike i referohem aspektit mikroskopik apo mikro reliefit, karakteristikat e përgjithshme siç janë : forma, thellësia, mund të jenë të ngjashme mirëpo në aspektin mikroskopik ato dallojnë, dhe ky dallim vjen si pasojë e procesit të prodhimit të pjesëve të armëve, sepse nuk është e mundur që gjatë procesit të prodhimit të armëve dhe pjesëve të tyre procesi të përsëritet apo të jetë i njëjtë 100 për qind apo absolut.

Konsumimi i tyre mund të ndodhë varësisht prej përdorimit, mirëpo meqenëse materiali nga të cilët janë ndërtuar apo prodhuar predhat, është më i butë sesa materiali nga i cili janë prodhuar tytat e

armëve konsumimi është relativisht i vogël, çka që nuk ndikon në masë të madhe në humbjen e karakteristikave të mjaftueshme individuale për ti indentifikuar, që një predhë është shkrepur nga një armë e caktuar .

Largësinë maksimale do ta arrinte nëse me armën do të shkrepesh në këndin 45 shkallë e që mund të jetë 2-3 kilometra apo edhe më tepër, mirëpo qëllimi i dizajnit të kësaj arme nuk ka qenë për të shkrepur përpjetë ose në këndë 45 shkallë mirëpo në këndë paralel me tokën, arma në fjalë ka shënjestrën e prapme të shkallëzuar për goditje të caktuar deri në 800 metra, mirëpo sipas specifikacioneve teknike të prodhuesit ajo e ka largësinë efektive 350 metra, d.m.th. gjasat për me goditur cakun janë më të mëdha deri në largësinë 350 metra, mirëpo nuk përjashtohet mundësi që ajo të goditë deri në 1 kilometër.

Nuk e di, sa predha fluturon përpjetë deri sa të arrijë shpejtësinë 0 e pastaj bie teposhtë nën ndikimin e forcës së gravitetit, por saktësisht nuk e di pasi që nuk ka të dhëna lidhur me këtë matje. Sipas matjeve eksperimentale që janë bërë, edhe nëse shkrepet drejtë përpjetë, predha nuk bie në pozitë ku është shkrepur mirëpo në bazë të dhënave diku deri në 200 metra.

Në këndin 45 shkallë, e ka largësinë maksimale mund të jetë 2-3 kilometra ndoshta më tepër e ndoshta më pak.

Kjo mund të llogaritet nëse dihet shpejtësia e matur në grykën e armës, pesha e predhës dhe koeficienti balistik i predhës dhe më pastaj kalkulohen dhe gjendet një kohë që i dihet me shku në pikën 0 deri me ra poshtë, në rastin konkret nuk e di.

Fillimisht arma iu është nënshtruar ekzaminimit fizik dhe përcaktimit nëse e njëjta është funksionale, janë bërë gjuajtje testuese me qëllim të sigurimit të mostrave model krahasimi si gëzhoja ashtu edhe predha, fillimisht janë ekzaminuar predhat model krahasimi , kemi përcaktuar cilat janë individuale të vjaskave, dhe më pastaj njëra nga predhat model krahasimi është krahasuar me ndihmën e mikroskopëve stereokrahasues dhe ka rezultuar se predha objekt ekspertimi ka të njëjtat karakteristika individuale me predhat model krahasimi, çka nënkupton se predha objekt ekspertimi është shkrepur nga tyta e armës objekt ekspertimi evidentuar me shifrën 1# .

Prokurorja e shtetit deklaroi se deri më tani mendojë që u shtjerrën të gjitha pyetjet për ekspertin dhe kam një dilemë nëse ka mundësi eksperti t' më skjaron çka kuptojmë me gjuajtjen nga 45 shkallë.

Eks.: Këndi 45 shkallë është këndi që e formon boshti i armës me sipërfaqen në raport me tokën.

Prokurori: Nëse gjuhet prej 2 armëve të njëjtit kalibër dhe të njëjtit lloj, predha e cila është gjuajtur si në rastin konkret, a mundet me pas të njëjta karakteristika nga të dy armët?

Eksperti: Edhe nëse armët prodhohen të njëjtën ditë, të njëjtën orë, njëra pas tjetrës në proces të prodhimit karakteristikat individuale i kanë të ndryshme, karakteristikat klasore i kanë të njëjta mirëpo ato individuale të cilat përdoren në procesin e identifikimit i kanë të ndryshme.

KTGJ:: A është vërtetuar që predha që iu është dorëzuar juve për ekzaminim, është gjuajtur nga arma e cila është marrë si dëshmi, e evidentuar dëshmia 1#?

Eks.: Po është vërtetuar që edhe predha edhe gëzhoja janë shkrepur nga arma objekt ekspertimi e cila evidentohet dëshmia 1#.

Av.P.: Nëse ka mundësi që t' na tregohet fotoja e armës dhe numri serik i numrit të armës, dhe të vërtetohet se a është kjo armë edhe e cekur edhe në ekspertizën e balistikës?

Prokurorja e shtetit ia tregojë foton e armës të akuzuarit, i cili e shikojë armën dhe numrin serik të armës.

Avokati P. K. si dhe i akuzuari pa vërejtje me rastin e shikimit të fotove të armës dhe numrit serik të armës të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Av.P. K.: bënë vërejtje meqenëse eksperti nuk ishte i qartë lidhur me kohën nga gjuajtja e pikës 0 deri në ramje, gjithashtu ekspertiza është bërë pas një kohe të gjatë, e cila mund të vie deri tek konsumimi i vjaskave dhe lugjeve të armës dhe predhës, gjithashtu në rastin konkret nuk e kanë bërë matjen distancës, shpejtësinë së predhës nga momentin i gjuajtje.

Eks. : Agjensia e Kosovës për Forenzikë edhe nëse bëhet një kërkesë e tillë nuk i ka kapacitetin me e bërë një matje të tillë.

Provave materiale.

Nga lista e dëshmimeve i datës 17.08.2014, gjykata ka vërtetuar se, nga i akuzuari janë konfiskuar arma A-47 Kallashnikov me nr. Serik : dhe një Karikator i zbrazur

Nga raportit informues me numër 2014-DB-1429 datës 17.08.2014, gjykata ka konstatuar se ; Me dt. 17.08.2014 rreth orës 15:50 janë njoftuar nga B-Baza që të bëjnë përcjelljen e një veture e cila ishte duke transportuar një person të lënduar në drejtim të Emergjencës së Spitalit ‘‘ Isa Grezda ‘’ në Gjakovë, Patrulla e përberë nga G.R. #8944 dhe H. Gj. #7252 kanë përcjell veturën Golf -II- deri në emergjencë , ku kanë mësuar se bëhet fjalë për një person i cili ishte qëlluar nga një plumb qorr në kokë.

Sipas djalit të tij M. Ll. , rreth orës 15:40 kishin qenë duke punuar në oborrin e shtëpisë së bashku me familjen , papritmas ishin dëgjuar disa të shtëna dhe pas disa sekondash prindi tij (baba) F. Ll. ishte rrezuar në tokë, në fillim kanë menduar se mos kishte ndonjë çrregullim shëndetësor, por pastaj kishin pa se kishte gjakderdhje nga koka ata kanë vërejtë se bëhet fjalë për plagë dhe pastaj ata e kishin nisur me veturë për ta dërguar në emergjencë , njëkohësisht ata kanë njoftuar edhe stacionin policor në Gjakovë.

Në Emergjencë ju ka dhënë ndihma e nevojshme si dhe konstatimi i mjekut ku personi i lënduar kishte një predh nga një plumb qorr në kokë , rreth orës 17:05 i lënduari është përcjellë në QKUK për tretman të mëtejshëm.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes datës 17.08.2014, gjykata konstaton se : Me dt. 17.08.2014 rreth orës 17:20 , Qendra operative në Pejë janë njoftuar nga se në Gjakovë , në fsh. L. K. Gj. , ka ndodhur një rast ku një person është dërguar me urgjencë në spital dhe në orën 17: 45 janë takuar me hetuesit regional të cilët ishin N.G. dhe E. B. , kanë shkuar në vendin e ngjarjes ku kanë arrite në orën 18:35n në vendin e ngjarjes kanë takuar patrullën Stacionit Policor Gjakovës, dhe kanë kontaktuar policet dhe hetuesit R.B. #7935 dhe H. S. #8705, në vendin e ngjarjes po ashtu kanë takuar edhe hetuesit S. Sh. #6024 dhe A. Zh. #9028 , ku pastaj rreth orës 20:00 kanë arrit në fsh. N. e P. respektivisht në shtëpinë e N. M. G. , pas njoftimit kanë hyrë në oborrin e shtëpisë kanë vërejtur një gëzhojë të kalibrit 7.62 x 39mm. Për gëzhojën e gjetur është njoftuar pronari i shtëpisë i cili ishte prezent gjatë gjithë kohës . Nga ai është kërkuar të dorëzohet arma me të cilën ishte shkrepur ai fishek. Pas një diskutimi i njëjti ka pranuar se arma është hedhur në një vend rreth 500 metra larg shtëpisë. M. B. dhe Hetuesi rajonal N. G. së bashku me personin N. G. kanë shkuar në vendin e quajtur të varrezat ku kanë vërejt një armë automatike të llojit AK 47 (ser# 024905-85) të hedhur në një gropë skaj rrugës së fshatit si dëshmia Nr#1.

Gëzhjoja e gjetur në oborrin e shtëpisë është evidentuar me Nr#3.

Nga raporti mjekësor i QKUK-së në Prishtinë i datës 25.09.2014, gjykata konstaton se, Gjendja e pacientit ku është konstatuar : I vetëdijshëm I orientuar në kohë dhe hapësirë Deficit i rëndë pyramidal majtas dhe është përshkruar terapia. I nënshkruar nga Dr. B. K. , neurokirurg.

Nga fletëlëshimi me epikrizë me numër 278/2014 datës 19.09.2014, gjykata konstaton se gjendja shëndetsore e pacientit F. Ll. j, dhe përmes Craniogramit vërehet predha metalike – plumb.

Nga fletëlëshimi nga QKUK-ja nr.7193 datës 08.10.2017, gjykata konstaton se pas analizave laboratorike, imazherike dhe klinike konkludojmë se për momentin nuk kemi të bëjmë me sëmundje akute kirurgjike, lëshohet në shtëpinë gjendje të përmirësuar shëndetësore.

Nga konstatimi skenografik dt.19.12.2014, gjykata konstaton se përshkruhet gjendja shëndetësore e pacientit F. LL. , nga Poliklinika ‘ M. G.’ Gj.. Nënshkruar nga Dr.G. L. Mr. sci Internist dhe gastrenterolog.

Nga raportet shtesë për të dëmtuarin F. Ll. ; nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko ligjor dr. V. H. i datës 05.01.2017, gjykata konstaton se është jap ky konstatim : Në bazë të raportit mjekësor, lëshuar nga Reparti i Emergjencës pranë Spitalit Rajonal Gjakovë, me nr. Protokolit 10951, me datë 17.08.2014, mes tjerash shihet me sa vijon: 1. Plagë e shkaktuar nga arma zjarrit në kokë. 2. Trup i huaj metalik në brendi të kokës.

Nga konstatimi dhe mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr.F. D. me nr. Ref. 02/2017, datë 05.05.2017, jep këtë mendim:

I. Diagnoza mjekësore të përshkruara në pikën 1 dhe 2 të gjetje –konstatimit, paraqesin : Plagë e shkaktuar nga arma zjarrit në regjionin tëmthor të anës së djathtë të kokës, grumbullimi traumatik gjaku në regjionin e bërthamës bazale të anës së djathtë të trurit, grumbullimi i gjakut në cipën e but dhe nën cipën e fortë në regjionin tëmthor të anës së djathtë të trurit , shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe si të tilla bëjnë pjesë në **dëmtime të rënda trupore.**

II. Diagnozat mjekësore të përshkruara në pikën 3) të Gjetje – Konstatimit , paraqesin sëmundje patologjike të barkut dhe të syve. Nënshkruar nga Dr. Fl. D. . mjeko ligjor .

I AKUZUARI në shqyrtimin gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar :

I akuzuari njoftohet nga KTGJ edhe njëherë për të drejtat e tij, i njëjti deklaroi se do të mbrohet duke u deklaruar dhe deklaroi se është i njohur me të drejtat e tij.

Në pyetjet e mbrojtësit ti akuzuari N. G. i përgjigjet:

Po mbetem pranë deklaratave të dhëna në polici me datat 18.08.2014 dhe me 21.12.2016, si dhe në prokurori me datë 08.05.2017.

Ditën me 17.08.2014, së pari kam ardhur në Gjakovë dhe kam pritur kamaret e djalit, kah ora 09:00/h, kemi shkuar në kish me e pagëzuar djalin, jemi kthyer në shtëpi, ka filluar ahengu se e kom pagëzuar djalin në Kishë, ahengu ka filluar rreth orës 10.00/h, kemi festuar duke pirë nga pak, ahengu ka zgjatur deri ka ora 14:00/h, me minuta saktë, pastaj kanë filluar me u shpërnda mysafirët.

Atë ditë kur këna pasur ahengun në shtëpi kam gjuajtur personalisht me armë, me kallash kam gjuajtur, kallashin e kemi pasur në shtëpi prej masë luftës. Me kallash kam gjuajtur kah ora 12:30 – deri kah ora 13:00/h, brenda asaj dite kam gjuajtur veç një herë, dy tri herash një pas një.

Në oborrin tim nuk ka gjuajtur askush tjetër, por në rrugë para derës ka pasur gjuajtje tjera. Kam gjuajtur në drejtim të Radoniqit, pasi që me tjera anë nuk kam pas si me gjuajtur se janë shtëpitë. Armën e kam lënë në pasllom.

Pasi kohës kur e ke lënë armën në pazllom, ka pasur gjuajtje tjera, në oborr timin jo. Nuk kam mundur ti dallojë sipas krismave se çfarë armë kanë qenë.

Armën ia kam dorëzuar policisë në prezencën e prokurorit kur kanë qenë në shtëpinë time, armën të cilën e kam dorëzuar pas një ore 1-2 që e kisha vendosur në pazllom, pastaj të njëjtën e kam fshehur në rrugë të varret nja 500-600 metra larg shtëpisë..

Gjatë kohës që e kam lënë armën aty, nuk e di a e ka përdorur dikush tjetër armën.

Gjatë ahengut që kam pasur në shtëpi, kam përdorur birra dhe raki.

Policia nuk më ka bërë ekzaminim lidhur me përdorimin e armës.

Në pyetjet e prokurorit i akuzuarit N. G. përgjigjet:

Mosha e djalit të cilin e kam pagëzuar, ka qenë 1 muaj e gjysmë, të njëjtit ia kemi ngjitur emrin A.

Atë ditë kemi pasur 50-60 mysafir, muzike ka qenë me digjej.

Në pyetjen e prokurorit.: Ju thatë se keni gjuajtur me armë dhe ahengu ka zgjatur deri në 14:30/h, po në polici ju keni deklaruar në deklaratën e dt. 18.08.2014 keni deklaruar se keni gjuajtur me armë në 15.00 ose 16.00/h. Cila është e vërteta ajo çka ke thënë në polici apo ajo çka po thua sot?

I akuzuari përgjigjet.: E vërteta është ajo çka kam deklaruar në seancën e sotme.

Prokurori i shtetit ia prezantojë deklaratën e tij të dhënë në polici me dt. 18.08.2014 ku ka deklaruar se ka gjuajtur me armë nga ora 15.00/h ose 16.00/h dhe e pyete a është ky nënshkrimi i juaj në këtë deklaratë?

I akuzuari deklaron se nënshkrimi në deklaratën e dhënë në polici me dt.18.08.2014 është i imi.

Kur kam gjuajtur me automat, karikatorin e kom pasur të mbushur full.

Ka gjuajtur 1 herë me automatë, Jo rafalë të plotë, kam gjuajtur një nga një.

Në momentin ku keni gjuajtur me armë ka qen në oborr, tek dyert e oborrit brenda.

Pas 1 ore 1,30 minuta, armën e kam lënë së pari në garazhe - pasllom, po pastaj pas një ore, - një orë e gjysmë e ka qar tek rruga e varreve aty armën e kam mbuluar me një najlon dhe do fletë-dushku, nuk e kam hequr karikatorin nga arma. Mbas nja 4-5 orëve, pasi kam gjuajtur kanë ardhur policia.

Kur ke gjuajtur, automatin kam mbajtur të drejtuar hava-sa të shkon dora lart.

Në pyetjen e prokurorit: Tha që ke gjuajtur 3-4 herë një nga një, por në vendin e ngjarjes janë gjetur vetëm një gëzhøjë, ku janë tjerat?

I akuzuari përgjigjet.: Nuk e di.

Në pyetjen e prokurorit: Sipas ekspertizë së balistikës gëzhjoja që është gjetur në oborrin e shtëpisë tuaj, dhe predhës që është nxjerrë nga koka e të dëmtuarit F.LI. është gjuajtur nga arma automatike që iu është konfiskuar nga ju. Çka keni me thënë për këtë?

I akuzuari përgjigjet.: Se automati është i imi dhe gëzhoja e gjetur në oborrin tim janë të mija, kurse predha që është nxjerrur nga i dëmtuari F. nuk është e imja.

Nuk kom pa se kam qenë me mysafir brenda në shtëpi, kurse ata kanë gjuajtur në rrugë.

Po e kom njoftuar policinë se ka pasur gjuajtje të tjera dhe se kanë gjuajtur në rrugë.

Vendi ku është mbajtur ahengu, shtëpia dhe pazllomi janë të rrethuara me mur.

Nuk ka gjetur policia ndonjë gëzhojë tjetër në rrugë. Nuk kom pa se dikush i ka mbledhur ato gëzhoja, nga arma e shkrepur

Po, e vërtetë se ma kanë matur promilat e alkoolit me aparat, kurse nuk është konstatuar edhe me nxjerrjen e gjakut sasia e alkoolit në gjak. Ka mbarimi i ndejë ka ora 14.30- 15.00/h atëherë kam qenë i dehur.

Kur kam përdorur armën mysafirët kanë qenë aty, sa ka qenë fillimi i ahengut.

Më herët armën- pushkën automatike , i cili është gjetur tek unë, para ditës kritike, nuk e kam përdorur. Me armë nuk kam përvojë.

Në pyetjen e Përfaqësuesi i autorizuar av.R. Gji. : Kur ka marrë vesh i akuzuari për lëndimin e të dëmtuarit?

I akuzuari përgjigjet.: Kam marrë vesh kur kam dal prej paraburgimit.

Në pyetjen e Përfaqësuesi i autorizuar av.R. Gj. A jeni interesuar për të dëmtuarin , për pasojat dhe si është gjendja e tij shëndetësore?

I akuzuari përgjigjet.: Më ka ardhur keq për te, pasi që të njëjtin e kemi edhe dhëndër të nunave ,vetëm se me ka ardhur keq për te.

Unë i kam treguar policisë se ku gjendet arma. Gëzhojën e kanë gjetur, në oborr.

Herën e parë kur kam dhënë deklaratë në polici, kam pasur mbrojtës av. N. D.

Në pyetjen e anëtarit të trupit gjykues.: Në deklaratën e dhënë në polici kur të kanë pyetur: çfarë kohe keni shkrepur saktësisht me armë? ju keni deklaruar : dikund rreth orës 15:00 ose 16.00/h. A të kujtohet rasti më mirë tani apo atëherë kur ke dhënë deklaratën në polici?

I akuzuari përgjigjet.: Më mirë më kujtohet pas rastit pasi që atëherë kam qenë i trollosur e ndoshta edhe i dehur, dhe më vonë më kujtohet saktë se çka ka ndodhur.

Gjykata nuk ja falë besimin deklaramit të akuzuarit pasi në rastin kur ka dhënë deklaratën në polici e ka dhënë një ditë pas ngjarjes kritike, që do të thotë, se nuk ka qenë në ndikim të alkoolit.

Në oborr e kom pas me plumba, kur e kam lënë në vendin tek varret nuk e kom këqyr, por ka pasur plumba, kur e kom marrë nuk e kom këqyr a ka pasur plumba apo jo, kur e ka marrë policia ka konstatuar se nuk ka pasur plumba tjerë në karikator.

Për veprën e dytë penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, e pranon në të gjitha fazat e procedurës , si në procedurën hetimore – paraprake dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Mbrojtjes të akuzuarit Gjykata nuk e merr për bazë meqenëse është dedikuar ikjes së përgjegjesisë penale.

Nuk është kontestuese se më dt. 17.08.2014, rreth orës 15:00 - 15:30 /h, në fsh N. e U. K. G. në shtëpinë e të akuzuarit N. G. ka pas aheng me rastin e pagëzimit të djalit të tij një muaj e gjysmë, se në ahengun me rastin e pagëzimit të djalit të tij A. , kanë qenë të ftuar 50-60 mysafir kemi pasur atë ditë.

Gjykatën nuk e bind mbrojtja e të akuzuarit se kanë shtënë persona të tjerë. Pasi që në vendin e ngjarjes është gjetur vetëm një gëzhojë për të cilën i akuzuari e ka pranuar së është shkrepur nga ai vet më armën e cila ju është sekuestruar.

Po ashtu gjykata nuk ja falë besimin kur thotë se kur ka gjuajtur me armë Kallash, ka qenë ora 14:30/h, po në polici ka deklaruar në deklaratën e dt. 18.08.2014 ka deklaruar se ka gjuajtur me armë në 15:00 ose 16:00/h. Se ka qenë ora 15:00 – 16:00 mund të vërtetohet edhe nga deklarata e të akuzuarit kur thotë se policia ditën kritike kanë ardhur 4 – 5 orë pas ngjarjes, në raportin policor të këqyrjes së vendit 2014 – DB – 1429 të dt. 17.08.2014 ceket se policia në vendin e ngjarjes ka shkuar ditën kritike në orën 20:00/h, që do të thotë se, nëse merret për bazë deklarata e të akuzuarit se policia ka ardhur mbas 4 – 5 orëve pas që ka gjuajtur me armë, nëse orës 20:00 i zbriten 5 orë, atëherë ngjarja ka ndodhur në mes orës 15:00 – 16:00/h, që do të thotë e vërteta është ajo çka ka thënë në polici me rastin e marrjes së deklaratës së tij, ku ka thënë se ka gjuajtur në mesë orës 15:00 - !6:00, andaj nuk është e saktë se ka gjuajtur në orën 14:30

Kur thotë se arma e tipit ASH-78, tipi -1, kalibër 7.62x39mm me numër serik 024905-85- 47- Kallashi është e tija dhe gëzhjoja e gjetur në oborrin e tij është e tija , por nuk është e tija predha (plumbi) i nxjerr nga koka e të dëmtuarit F.LI. , kur dihet se nga ekspertiza balistike është vërtetuar se predha e nxjerr nga koka e të dëmtuarit është gjuajtur nga arma e cila ju është konfiskuar të akuzuarit N. , i cili ishte goditur me dt. 17.08.2014 rreth orës 15:00-15:30/h.

Se predha është gjuajtur nga arma e tipit ASH-78, tipi -1, kalibër 7.62x39mm me numër serik 024905-85- 47- Kallash pronë e të akuzuarit, është vërtetuar edhe nga **Raporti i ekspertimit AKF/2016 – 1465/2016-2016 dt.04.11.2016, ku në mendimin përfundimtar është konstatuar:**

Dëshmia 1 është një (1) pushkë automatike ASH-78 Tip – 1, kopje e pushkës automatike AK – 47 e kalibrit 7.62 x 39mm me numër serik ‘ ‘ 024905-85’ ’ . Arma është funksionale.

Dëshmia 2 është një (1) karikatorë i zbrazët , me kapacitet prej tridhjetë fishekëve të kalibrit 7.62 x 39, i dizajnuar për pushkë automatike ASH – 78 tip-1 dhe versionet e saja . Karikator i është funksional.

Dëshmia 3 është një (1) gëzhojë , e cila është pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62 x 39mm . Kjo gëzhojë është shkrepur nga pushka automatike e dëshmisë 1.

Dëshmia 4 është një (1) predhë , e cila është pjesë e fishekëve të kalibrit 7.62 x 39mm. Kjo predhë është shkrepur nga pushka automatike e dëshmisë 1.

Nuk është gjetur ndonjë përputhshmëri me artikujt e Librisë se rasteve të Hapura.

Nga sa u tha më lartë Gjykata pa dyshim ka vërtetuar se i akuzuari N. G. ka vepruar me pakujdesi të vetëdijshme edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasojat e ndaluara mund të shkaktohen si rezultat i veprimit të tij edhe pse në rrethana dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi, kur ka gjuajtur me armën e tij në mënyrë të pa kontrolluar, ku edhe ka goditur në anën e djathtë këtu të dëmtuarin F. Ll. , dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore që në atë moment kanë qenë të rrezikshme për jetën, i njëjti nga plaga e marr ka mbetur i pa aftë për çdo punë pasi nuk i punon dora dhe këmba e majtë, deri sa i dëmtuari F. ishte duke punuar në oborrin e tij të shtëpisë së vet në fsh. L. K. Gj. , me çka ka kryer veprën penale të shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha si më lart Gjykata pa dyshim ka vërtetuar se i akuzuari N. G. me dashje ka gjuajtur me armën e tij të tipit A-47 në drejtim lartë (kah qielli) dhe një predhë ka shkuar në drejtim të shtëpisë së dëmtuarit F. Ll. dhe deri sa F. Ll. ishte duke punuar në oborrin e tij e godet një predhë në kokë dhe i shkaktonte lëndim të rëndë trupore, të rrezikshëm për jetën në momentin e shkaktimit dhe pasoja të përhershme, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr.F. D. dt.05.05.2017.

Pas përfundimit të procedurës së provave dhe pas dëgjimit të mbrojtjes së të akuzuarit dhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: dëshmitë e dëshmitarëve M. Ll. , D. Ll. , të dëmtuarit F. Ll. të akuzuarit, nga raporti i ekspertimit nga Agjensia e Kosovës për Forenzikë, ekspertit të balistikës I. K. j AKF/2016-1465/2016-1216 datës 04.11.2016, listës së dëshmive të datës 17.08.2014, raportit mjekësor i QKUK në Prishtinë i datës 25.09.2014, fletëlëshimit me epikrizë me nr.278/2014, datës 19.09.2014, fletëlëshimit nga QKUK menr.7193 datës 08.10.2014, konstatimi skenografik të dëmtuarit i datës 19.12.2014, raporteve shtesë për të dëmtuarin, konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. V. H. me nr.ref. 01/2017 datës 05.01.2017, konstatimit dhe mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr.F. D. , me nr. Ref. 02/2017, datë 05.05.2017, foto dokumentacioni për pushkën automatike ASH-78, (AK- 47) tip-1, kalibër 7.62-39mm, me numër serik. 024905-85, fotoalbumi i vendit të ngjarjes dt. 17.08.2014, listës së armës së konfiskuara me numër të dosjes 2014-DB-1429, dt. 17.08.2014.

Nga gjendja faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi pa dyshim rrjedhë se në veprimet e të akuzuarit N.G. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do të zvogëlonin ose përjashtonin përgjegjësinë penale të të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.5/3, të KPK-së.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin N. G. , Gjykata mori gjendjen e tij ekonomike, se i njëjti është penduar thellë për veprimet e kryera, kjo kishte ndodhur për herë të parë, premtimin se në të ardhmen nuk do të bien ndesh me ligjin, se është baba i fëmijës 3 vite e gjysmë, i cili fëmijë-në ditën kritike i kishte një muaj e gjysmë, dhe se veprën penale të lëndimit të rëndë e ka kryer nga

pakujdesia e vetëdijshme konform nenit 23 par. 2 të KPRK-së, e duke i vlerësuar këto rrethana lehtësuese konform nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë.

Gjykata po ashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do t'iu shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe ky dënim do të ketë efekt preventivë gjeneral për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par.1 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar ne nenin 463 par.2 të KPPK-së, të dëmtuarin për realizimin e kërkesës se vet pasurore juridike gjykata e udhëzoi ne kontest te rregullt juridiko civil.

Pas shpalljes së këtij aktgjykimi gjyqtari i udhëzojë palët me të drejtë ankese, se mund t 'a parashtrajnë në përputhje me nenin 368. Par.1 të KPRK-së.

GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë
PKR.nr.87/17 me datë 11.01.2018

Sekretarja juridike,

Arbënore Basha

Kryetari i trupi gjykues-Gjyqtari,

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër aktgjykimi lejohet ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes të kësaj gjykate.